



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 17 korrik 2019

Z. Fatmir Matoshi, Ministër  
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Pallati i Drejtësisë  
10000 Prishtinë

**KËRKESË PËR MASË TË PËRKOHSHME**  
lidhur me  
**ÇËSHTJEN E OPERIMIT TË**  
**HIDROCENTRALEVE NË VEND DHE NDIKIMIT NË MJEDIS**

**Rastet**  
**Ex officio 365/2018**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit**  
**dhe**  
**Ankesa nr. 82/2019**  
**Dobrivoje Stevanoviq dhe 1200 të tjerët**  
**kundër**  
**Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**

I nderuari z. Matoshi,

Avokati i Popullit, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka iniciuar hetime sipas detyrës zyrtare *Ex officio*, lidhur me operimin e hidrocentraleve në Deçan, si dhe ka iniciuar hetime bazuar në ankesën e z. Dobrivoje Stevanoviqit dhe 1200 të tjerëve, që ka të bëjnë me çështjen e hidrocentraleve në Shtërpce. Hetimet kanë të bëjnë me ligjshmërinë e operimit të hidrocentraleve në Deçan dhe në Shtërpce dhe ndikimin e tyre në mjedis.

Në bazë të pretendimeve të ankuesve dhe informatave tjera që i ka Avokati i Popullit, çështja e operimit të hidrocentraleve të lartpërmendura është duke u përcjellë me shumë paqartësi, si për shkak të mungesës së transparencës së institucioneve përgjegjëse për ligjshmërinë e operimit, e po ashtu edhe për shkak të mangësive lidhur me procesin e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje.

Derisa në publik është duke u zhvilluar një debat i gjerë dhe gjithëpërfshirës lidhur me këtë çështje, institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur asnjëherë të jenë mjaftueshëm të qarta lidhur me ligjshmërinë e operimit të hidrocentraleve dhe veprimet e tyre kanë vazhduar të ngelin të zbehta në drejtim të zgjidhjes së çështjes, përderisa reagimet dhe pakënaqësitë e qytetarëve dhe të shoqërisë civile janë në rritje. Të gjitha përpjekjet e deritanishme të

organeve për ta adresuar problemin dhe pakënaqësitë e qytetarëve janë duke u treguar si mjete joefektive për zgjidhjen e problemit.

Duke vërejtur se në rastin konkret kemi të bëjmë me ndikimin në mjedis dhe në ujëra, Avokati i Popullit, bazuar në Ligjin nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, qëllimi i të cilit është mbrojtja e resurseve ujore nga ndotja, nga tej shfrytëzimi dhe nga keqpërdorimi, i cili përcakton në mënyrë të qartë se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore nga fusha e resurseve ujore, përfshirë edhe ligjet tjera nga fusha e mjedisit jetësor, vlerëson se Ministria është organi kompetent i cili duhet të japë sqarime të qarta lidhur me këtë çështje.

**Avokati i Popullit, bazuar në nenin 18, paragrafi 5, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit<sup>1</sup>, duke konsideruar se situata mund të ketë pasoja të pariparueshme në mjedis, i rekomandon Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që t'i pezullojë aktivitetet e hidrocentraleve në Deçan dhe në Shtërpce, deri në dhënien e sqarimit për ligjshmërinë e operimit të hidrocentraleve në fjalë, si dhe sqarimet për kompetencat mes autoriteteve përgjegjëse.**

Avokati i Popullit deri te ky rekomandim ka ardhur pas një kohe të gjatë të monitorimit të situatës dhe vlerësimit se kriteri substancial për rekomandimin e një pezullimi të tillë është përmbushur qartazi në këtë rast. Shkaku i rekomandimit për pezullimin e aktiviteteve të hidrocentraleve në fjalë është ndikimi i qartë në degradimin e mjedisit dhe të ujërave të vendit; në të drejtën për mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm, e drejtë e garantuar me nenin 52 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [*Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor*] dhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Masa e përkohshme do të zgjasë deri në vlerësimin e Avokatit të Popullit për pranimin e sqarimeve të mjaftueshme nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe nga organet tjera relevante përkitazi me ligjshmërinë e operimit të hidrocentraleve në fjalë, si dhe sqarimet për kompetencat mes autoriteteve përgjegjëse.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 18, paragrafët 18.4 dhe 18.6, si dhe me nenin 25 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ju lutemi që përgjigjen tuaj, përkitazi me këtë çështje, të na e dërgoni jo më vonë se deri më **17 gusht 2019**.

Me nderime,

  
Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

<sup>1</sup> Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 18, par. 5: “Nëse gjatë hetimeve, Avokati i Popullit konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik, mund të rekomandojë që autoriteti kompetent ta pezullojë ekzekutimin e vendimit në fjalë deri në përfundimin e hetimeve lidhur me këtë çështje nga ana e Avokatit të Popullit.”

- CC: Z. Kadri Veseli, Kryetar  
Kuvendi i Kosovës
- CC: Z. Ramush Haradinaj, Kryeministër  
Zyra e Kryeministrit
- CC: Z. Valdrin Lluka, Ministër  
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- CC: Z. Muharrem Nitaj, Kryetar  
Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor
- CC: Znj. Duda Balje, Kryetare e Komisionit  
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe  
Petizione
- CC: Z. Arsim Janova, U.d. kryesues i Bordit  
Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRrE)
- CC: Z. Bashkim Ramosaj, Kryetar  
Komuna e Deçanit
- CC: Z. Bratislav Nikoliq, Kryetar  
Komuna e Shtërpces